



KOLEGJI - COLLEGE  
**BIZNESI**  
Prishtinë

[ëëë.kolegjibiznesi.com](http://ëëë.kolegjibiznesi.com) | [info@kolegjibiznesi.com](mailto:info@kolegjibiznesi.com)

038 500 878 | 044 500 878 | 049 500 878

Prishtinë, Ulpianë, rr. "Motrat Qiriaz" nr. 29

<b>PLANPROGRAMI MËSIMOR-SYLLABUS</b>					
Niveli i studimeve	Bachelor	Programi	Juridik i përgjithshëm	Viti Akademik	2019-20
Lënda	<b>EKZEKUTIMI I SANKSIONEVE PENALE</b>				
Viti	IV	Statusi i lëndës	Obligative	ECTS/kredi	6
Semestri	VII				
Javët mësimore	15		Orët mësimore	Ligjërata	Ushtrime
				2	1
Metoda e mësimimit	Ligjërata, ushtrime, punime, konsultime, teste, raste studimi, detyra, ushtrime etj.				
Konsultime	Dy orë pas ligjëratave				
Mësimdhënësi	<b>Dr. Lulzim Farizi</b>		Tel/mob	044-474-488	
			e-mail	<a href="mailto:lulzim_farizi@hotmail.com">lulzim_farizi@hotmail.com</a>	
Asistenti			Tel/mob		
			e-mail		
<b>Qëllimi studimor dhe përmbajtja e lëndës</b>			<b>Përfitimet e Studentit</b>		
<p>Kjo lëndë ka për qëllim që të ofrojë njohuri të avancuara për studentë lidhur me qasjet e ndryshme teorike dhe metodologjike që kanë të bëjnë me problemet themelore të ekzekutimit të sanksioneve penale në shoqërinë bashkëkohore. Përmes kësaj lënde, studentët do të kenë mundësi që t'i thellojnë njohuritë e tyre lidhur me rregullimin ligjor të kësaj fushe dhe standardet ndërkombëtare që duhet zbatuar lidhur ekzekutimin e sanksioneve penale dhe trajtimin e personave të dënuar. Gjatë shtjellimit të këtyre njësive mësimore, studentët do të kenë mundësi që të kenë qasje në burime të shumta bashkëkohore, akte juridike penitensiare dhe materiale të tjera shtesë, që kanë të bëjnë me ekzekutimin e sanksioneve penale në shoqërinë bashkëkohore, me vështrim në posaçëm në Republikën e Kosovës.</p>			<p><b>Njohurit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Njohurit bazë mbi shkencën e ekzekutimit të sanksioneve penale</li> <li>Njohuritë mbi format e reagimit ndaj kriminalitetit përgjatë historisë dhe formave të zbatimit të dënimeve</li> <li>Njohuritë mbi llojet e dënimeve</li> <li>Njohuritë mbi sistemet kryesore të dënimit me burgim</li> <li>Njohurit mbi tretmanin e personave të dënuar dhe kyqjen e tyre në procesin e riedukimit dhe riintegritimit</li> <li>Njohurit mbi organizimin dhe funksionimin e organeve për trajtimin e personave të dënuar</li> <li>Njohurit mbi formën e klasifikimit të personave të dënuar</li> <li>Njohurit mbi të drejtat e personave të cilët janë në procesin e vuajtjes së dënimit</li> </ul> <p><b>Aftësitë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Aftësitë e komunikimit dhe prezantimit,</li> <li>Aftësitë e punës në ekip,</li> </ul>		

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aftësitë e dallimit të formave të tretmanit të personave të dënuar</li> <li>• Aftësitë e të kuptuarit të të drejtave themelore të personave të dënuar</li> <li>• Aftësitë e kuptimit të dallimit të formave të aplikimit të formave të dënimit dhe zhvillimin e procesit të edukimit dhe integritit të tyre</li> </ul>
--	---

### METODOLOGJIA PËR REALIZIMIN E TEMAVE MËSIMORE

Në pjesën më të madhe të kohës do të organizohen ligjërata interaktive, që d.m.th. se përveç ligjërimit nga ana e mësimitdhënësit, kyçen edhe studentët, qoftë duke pyetur apo edhe duke diskutuar dhe këmbyer mendimet e tyre lidhe me çështjet tematike që janë objekt i ligjëratis.

- punimet seminarike: Studentët do të kenë mundësi të përcaktohen për ndonjë temë apo punim seminarik, ku para fillimit të punës së tyre, atyre u ofrohen udhëzimet elementare lidhur me hartimin e punimeve të tilla, dhe pas përfundimit të tyre ata kanë mundësi të prezantimit para studentëve të tjerë të rezultateve të punimeve të këtilla, ku edhe do të zhvillohet debati lidhur me temat e trajtuara.

Grupe të vogla të studentëve: Do të bëhet përpjekje në aplikimin e punës grupore me studentë, ku ata ndahen në grupe të vogla me qëllim të debatimit dhe kyçje së këtyre grupeve në trajtimin e temave të ndryshme që do të jenë objekt i ligjërimit.

- Zbatimi i metodave bashkëkohore të ligjërimit: Gjatë punës me studentë do të përdoren metoda dhe teknika të ndryshme dhe bashkëkohore të ligjërimit të cilat do të jenë në funksion të shpjegimit të procedurës penale gjatë zhvillimit të hetimeve, dhe gjyqimit.

### KUSHTET PËR REALIZIMIN E TEMËS MËSIMORE

Për realizimin e temës përkatëse duhet të jetë përgatitja e nivelit të duhur e mësimitdhënësit, të shfrytëzohen të gjitha mjetet konkretizuese, që nevojiten. Gjithashtu, paraprakisht duhet të vlerësohet edhe niveli i studentëve dhe të qartësohen temat gjatë ligjërimit.

Mënyra e vlerësimit të studentit (në %):		
Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 30%	Vlerësimi në %	Nota përfundimtare
	91-100	10 (dhjetë)
	81-90	9 (nëntë)
	71-80	8 (tetë)
	61-70	7 (shtatë)
	51-60	6 (gjashtë)

<b>OBLIGIMET E STUDENTIT</b>				
<b>Ligjërata</b>		<b>Ushtrime</b>		
Vijimi i Ligjëratave Pjesëmarrje aktive, Punime seminarike, projekte, Pjesëmarrje ne teste dhe ushtrime, Provimi përfundimtar.		Pjesëmarrje ne ushtrime Puna individuale dhe grupe ne raste studimi, Pjesëmarrje diskutime.		
<b>NGARKESA E STUDENTIT PËR LËNDËN</b>				
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/Javë</b>	<b>Gjithsejtë</b>	
Ligjërata	2	15	30	
Ushtrime	1	15	15	
Punë Praktike				
Kontakte me mësimdhënësin	1	15	15	
Ushtrime në teren	5	2	10	
Kolekfiume/seminare	5	2	10	
Detyra të shtëpisë	1	15	15	
Koha e studimit vetanak	2	15	30	
Përgatitja përfundimtare për provim	10	1	10	
Koha e kaluar ne vlerësime (teste, kuiz, provimi final)	5	2	10	
Projektet propozimet	5	1	5	
Vërejtje: 1 ECTS kredi = 25 orë angazhim, p.sh. nëse lënda i ka 6 ECTS kredi studenti duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 150 orë		Ngarkesa totale:	<b>150</b>	
Jav	<b>Ligjërata</b>		<b>Ushtrime</b>	
	Tema	Orët	Tema	Orët
1	Kuptimi dhe lënda e studimit të Ekzekutimit të sanksioneve penale -Kuptimi i shkencës së Ekzekutimit të sanksioneve penale -Lënda e studimit të Ekzekutimit të sanksioneve penale  Ragip Halili, <i>Penologjia</i> , Prishtinë, 2014, fq. 13-23	2	Analizë mbi nocionin dhe kuptimin e shkencës së ekzekutimit të sanksioneve penale	1
2	Format e reagimi ndaj kriminalitetit gjatë historisë -Kuptimi dhe rëndësia -Format e reagimit ndaj kriminalitetit -Reagimi privat -Reagimi publik  Ragip Halili, <i>Penologjia</i> , Prishtinë, 2014, fq. 27-50	2	Analizë krahasimore mes reagimit privat dhe publik ndaj kriminalitetit përgjatë historisë	1

3	<p>Karakterit dhe llojet e sanksioneve penale para paraqitjes së dënimit me burgim</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Llojet e dënimeve para paraqitjes së dënimit me burgim</li> <li>-Dënimet me burgim dhe ekzekutimi i tyre</li> <li>-Paraqitja e dënimeve me burgim dhe burgjet e para</li> <li>-Faktorët e paraqitjes së dënimeve me burgim</li> <li>-Format e dënimeve me burgim dhe transformimi i tyre</li> </ul> <p>Ragip Halili, <i>Penologjia</i>, Prishtinë, 2014, fq. 85-94</p>	2	<p>Analizë mbi dënimet me burg, faktorët e paraqitjes dhe transformimi i tyre</p>	1
4	<p>Sistemet kryesore të ekzekutimit të dënimit me burgim</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Kuptim dhe llojet</li> <li>-Sistemi i burgut kolektiv</li> <li>-Sistemi i izolimit ose i qelisë</li> <li>-Sistemi i heshtjes ose i Obërnit</li> <li>-Sistemi progresiv</li> <li>-Sistemi i pikëve ose i Makonakut</li> <li>-Sistemi i klasifikimit ose i Gjenevës</li> <li>-Sistemi modern ose bashkëkohor</li> </ul> <p>Ragip Halili, <i>Penologjia</i>, Prishtinë, 2014, fq. 103-124</p>	2	<p>Analizë mbi sistemet më të njohura përgjatë historisë mbi ekzekutimin e dënimeve me burgim</p>	1
5	<p>Ekzekutimi i dënimeve me burgim dhe tretmani i të dënuarve</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Procesi i riedukimit dhe riintegrit</li> <li>-Tretmani i të dënuarve dhe individualizimi i tretmanit (trajtimit)</li> <li>-Observimi dhe studimi i personave të dënuar</li> <li>-Klasifikimi i personave të dënuar</li> <li>-Klasifikimi dhe kategorizimi i institucioneve korrektuese</li> </ul> <p>Ragip Halili, <i>Penologjia</i>, Prishtinë, 2014, fq. 145-170</p>	2	<p>Ushtirime dhe analizë mbi formën e tretmanit të të dënuarve dhe procesi i zhvillimit të riedukimit dhe riintegrit</p>	1
6	<p>Mjetet dhe metodat e trajtimit të të dënuarve me burgim</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Kuptimi dhe rëndësia</li> <li>-Puna e personave të dënuar</li> <li>-Puna e personelit penitenciar me personat e dënuar</li> </ul> <p>Ragip Halili, <i>Penologjia</i>, Prishtinë, 2014, fq.171-</p>	2	<p>Analizë mbi metodat e tretmanit të të dënuarve gjatë vuajtjes së dënimit në burg</p>	1

	186			
7	Vlerësimi i parë intermedial	2	Testi i parë	1
8	-Metodat e tretmanit grupor me personat e dënuar -Vetëorganizimi i personave të dënuar -Arsimimi dhe ngritja profesionale e personave të dënuar -Aktivitete kulturore, zbavitëse dhe sportive me të dënuar  Ragip Halili, <i>Penologjia</i> , Prishtinë, 2014, fq.187-198	2	Analizë mbi metodat e tretmanit grupor me personat e dënuar	1
9	Organizimi i ekzekutimit të sanksioneve penale -Organizimi dhe struktura e organeve dhe shërbimeve kryesore -Ministria e Drejtësisë -Shërbimi Korrektues i Kosovës -Shërbimi Sprovues i Kosovës -Struktura dhe organizimi i brendshëm i institucioneve korrektuese  Ragip Halili, <i>Penologjia</i> , Prishtinë, 2014, fq. 199-206	2	Analizë mbi rolin, organizimin dhe funksionimin e organeve të shërbimeve kryesore	1
10	Pozita e personave të dënuar gjatë mbajtjes së dënimit me burgim -Fillimi i ekzekutimit të dënimit me burgim ose burgim të përjetshëm -Rastet e shtyrjes së fillimit të ekzekutimit të dënimit -Pranimi, vendosja, ushqimi dhe veshëmbathja e të dënuarve -Të drejtat e personave të dënuar gjatë qëndrimit në institucionet korrektuese -Benificionet e të dënuarve gjatë qëndrimit në institucione korrektuese  Ragip Halili, <i>Penologjia</i> , Prishtinë, 2014, fq. 213-222	2	Analizë mbi pozitën e personave të dënuar gjatë vuajtjes së dënimit	1

11	-Detyrimet e personave të dënuar -Ruajtja e rendit dhe e disiplinës në institucionet korrektuese -Transferimi, pezullimi dhe lëshimi në liri i të dënuarve -Lirimi me kusht i të dënuarve me burgim  Ragip Halili, <i>Penologjia</i> , Prishtinë, 2014, fq. 223-233	2	Analizë mbi të drejtat dhe obligimet e personave të dënuar gjatë vuajtjes së dënimit	1
12	Ekzekutimi i dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm -Ekzekutimi i dënimeve plotësuese -Ekzekutimi i masave të trajtimit të detyrueshëm  Ragip Halili, <i>Penologjia</i> , Prishtinë, 2014, fq. 235-246	2	Analizë mbi dënimet plotësuese dhe format e tyre	1
13	Ekzekutimi i sanksioneve ndaj të miturve -Ekzekutimi i masave të diversitetit ndaj të miturve -Ekzekutimi i masave edukative ndaj të miturve  Ragip Halili, <i>Penologjia</i> , Prishtinë, 2014, fq.257-265	2	Analizë dhe ushtrime mbi ekzekutimin e masave sanksionuese ndaj të miturve	1
14	Vlerësimi i dytë intermedial	2	Analizë dhe përsëritje të materialit	1
15	-Ekzekutimi i dënimeve ndaj të miturve -Ekzekutimi i masave të trajtimit të detyrueshëm rehabilitues ose trajtmi i detyrueshëm psikiatrik ndaj të miturve  Ragip Halili, <i>Penologjia</i> , Prishtinë, 2014, fq. 265-274	2	Testi i dytë. Analizë mbi ekzekutimin e masave të trajtimit të detyrueshëm të personeve të mitur	1

#### LITERATURA

**Literatura bazë:**

Ragip Halili, *Penologjia*, Prishtinë, 2014.

Rexhep Gashi, *Ekzekutimi i dënimeve alternative*, Prishtinë, 2013.

Shlomo G. Shoham (editor), Martin Kett (editor), Ori Beck (editor), *International Handbook of Penology and Criminal Justice*, Taylor @ Francis, Inc., 2007.

Thomas Blomberg, Karol Lucken, *American Penology: A history of control*, Transaction Publisher, 2010.

Dirk V. Zyl Smit, Sonja Snacken, *Principles of European Prison Law and Policy: Penology and Human Rights*, Oxford University Press, USA, 2009.

**Literatura shtesë:**

Curt R. Blakely, *Prisons, Penology and Penal Reform: An Introduction to Institutional Specialization*, Peter Lang Publishing, 2007.

Gary E. Lavigna, *Alternative to punishment*, Ardent Media Inc., 2007.  
 Rexhep Gashi, *Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri*, Prishtinë, 2001.  
 Rexhep Gashi, Metije Ademi, *Probation in Europe – Kosovo*, botuar nga Confederation of European Probation (CEP), 2014, f. 40, online:  
[http://ëëë.cep-probation.org/default.asp?page\\_id=157&map\\_id=152](http://ëëë.cep-probation.org/default.asp?page_id=157&map_id=152).  
 Susan Easton, Christine Piper, *Sentencing and Punishment*, Oxford University Press, 2005.  
 Joan Petersilia (editor), *Community Corrections: Probation, Parole, and Intermediate Sanctions* (Edition 1), Oxford University Press, USA, 1997.  
 David Scott, *Penology*, Saga Publications, 2008.

**Gazetat dhe materiale te tjera**

Punishment @ Society (The international Journal of Penology); Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, Prishtinë, 2013; Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Prishtinë, 2010.

**VËREJTJE**

Për çdo temë mësimore, studentët do të pajisen me materiale të nevojshme në gjuhën shqipe. Në fund të çdo ore mësimore, grupet e caktuara të studentëve do të angazhohen me detyrë apo rast studimi lidhur me temën e ligjësuar. *Rezultatet e arritura nga ajo detyrë, grupet e studentëve duhet t'i prezantojnë dhe diskutojnë ato në orën e ushtrimeve.*

**VËREJTJE PËR STUDENTIN**

- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore;
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe punimet seminarike, të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet ti përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin e hulumtues dhe teknik të punimit;
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqendrohen vetëm në njohuritë personale.
- Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.

**Profesori i lëndës:**

**Prof. Ass. Dr. Lulzim Farizi**